# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5544
E shtunë, 4 gusht 2018
çmimi 0.40 €



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


## Haradinaj kërkon rritjen e shkallës së gatishmërisë në vend

FAQE 7



FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMADAN QEHAJA FAQE 4-5

# Shkëmbimi i territoreve sjell rrezikshmëri



Njohësi i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka bërë me dije se është e nevojshme marrja e masave në aspektin e sigurisë meqë, siç thotë ai, situata është e ndërlikuar. Ai ka mirëpritur rritjen e gatishmërisë së institucioneve të sigurisë në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Qehaja u ka bërë thirrje institucioneve të Republikës së Kosovës t'i ndërmarrin hapat e nevojshëm për të parandaluar çfarëdo lloj autonomie për veriun që mund ta shpallin serbët në atë pjesë. Qehaja ka folur edhe për idenë e shkëmbimit të territoreve. Ai ka pohuar se një ide e tillë është e rrezikshme në aspektin e sigurisë dhe Kosova do të dilte humbëse në këtë aspekt pasi, sipas tij, veriu për Kosovën ka një rëndësi të posaçme

PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, KA MBAJTUR TË PREMTEN KONFERENCË PËR MEDIE FAQE 3

## Thaçi: Çështjen e korrigjimit të kufirit me Serbinë do ta paraqes në dialog

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se në procesin e dialogut me Serbinë do ta prezantojë çështjen e korrigjimit të kufirit ndërmjet dy shteteve, duke përmendur me këtë rast përfshirjen e komunave jugore të Serbisë, Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, në kuadër të territorit të Kosovës. Ai ka ftuar t'i bashkohen kësaj ideje edhe individët që po e kritikojnë për këtë kauzë. Presidenti ka treguar se shumë vende në botë kanë korrigjuar kufijtë e tyre përmes bisedimeve pa pasur nevojë të ngrehen tensione apo konflikte





## Berisha: FSK-ja është e gatshme për transformim në Forca të Armatosura

FAQE 6

## AKTUALE



**STRATEGJIA SERBE PËR SHKËMBIMIN E TERRITOREVE** F. 11

Dr. Sabri KIÇMARI



**KUSH E URREN ADEM DEMAÇIN E URREN VETVETEN** F. 12-13

Izmi ZEKA

**DORËZOHEN 82 KALLËZIME PENALE PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË** F. 7

## EKONOMI

**KOSOVA RREZIKON HUMBJEN E RRETH 80 MILIONË EUROVE NGA BE-ja** F. 8

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DO TA MENAXHOJË ZYRËN PËR MONITORIMIN E TË DREJTAVE TË PASAGJERËVE** F. 9

## KULTURË

**TESTAMENTI I ADEM DEMAÇIT** F. 10

Agim VINCA

## SPORT

**VIT I SUKSESSHËM PËR DRITËN** F. 14


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Veseli: Askush s'mund t'i lëndojë raportet Kosovë - Turqi



**Prishtinë, 3 gusht** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka takuar të premten deputetët e Grupit Parlamentar 6+, me të cilët ka ndarë shqetësimin e akteve të fundit, ku disa qytetarë kanë djegur flamurin e Republikës së Turqisë. Në profilin e vet në "Facebook" Veseli ka shkruar se askush nuk mund t'i lëndojë raportet e Republikës së Kosovës me Turqinë. "Me deputetët e Grupit Parlamentar 6 +, në një takim që pata sot, ndamë shqetësimin e përbashkët për aktin e dënueshëm ndaj simboleve të Republikës së Turqisë. Shteti i Kosovës, populli i Kosovës, i respekton dhe i nderon miqtë e vet, kulturën, simbolet dhe identitetin e tyre. Kosova ka raporte shumë të mira me Turqinë dhe askush nuk mund t'i lëndojë ato, e as nuk do ta lejojmë një gjë të tillë", ka shkruar Veseli.

# DASh: ShBA-ja e gatshme t'i ndihmojë Kosovën dhe Serbinë për dialogun

Departamenti Amerikan i Shtetit thekson se ShBA-ja është e gatshme t'i dëgjojë dhe t'i ndihmojë palët për gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët. "Normalizimi i plotë i marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës është thelbësor për qëndrueshmërinë rajonale. Normalizimi, po ashtu, do t'u hapte rrugë të qartë të dyja vendeve drejt anëtarësimit eventual në BE. Tani është koha që palët të jenë kreative dhe fleksibile", thuhet në deklaratën e Departamentit Amerikan të Shtetit




**Uashington, 3 gusht** - Shtetet e Bashkuara thonë se zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis Kosovës dhe Serbisë duhet të vijë nga vetë palët dhe të jetë në duart e tyre. Në një deklaratë për "Radion Evropa e Lirë", Departamenti Amerikan i Shtetit thekson se "ShBA-ja është e gatshme t'i dëgjojë dhe t'i ndihmojë palët në gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët". "Normalizimi i plotë i marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës është thelbësor për qëndrueshmërinë rajonale. Normalizimi, po ashtu, do t'u hapte rrugë të qartë të dyja vendeve drejt anëtarësimit eventual në Bashkimin Evropian. Shtetet e Bashkuara mbështesin fuqishëm dialogun e lehtësuar nga BE-ja midis Beogradit dhe Prishtinës. Tani është koha që palët të jenë kreative dhe fleksibile", thuhet në deklaratën e Departamentit Amerikan të Shtetit. Kjo vjen si përgjigje pas sugjerimeve të fundit se zgjidhja e mundshme e mosmarrëveshjeve Kosovë - Serbi mund të arrihet me shkëmbim territoresh në vija etnike. Presidentët e të dyja vendeve, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq, e kanë hedhur idenë - i pari për korrigjim kufijsh, tjetri për ndarje territoriale. Ndërkaq, Bashkimi Evropian ka kërkuar nga Prishtina dhe Beogradi mos të ketë tensione në Kosovë të cilat mund t'i dëmtojnë përpjekjet e përbashkëta për arritje të një marrëveshjeje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë.

# Vuçiqi lut serbët në Kosovë që mos ta shpallin autonominë



**Beograd, 3 gusht** - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, u është drejtuar me një letër të hapur qytetarëve serbë të Kosovës, përmes së cilës u ka thënë se përderisa ai të jetë në krye të shtetit të Serbisë nuk do të lejojë dhunë të organizuar mbi serbët dhe shenjtërit e tyre, as përndjekjen e tyre. Këtë letër Vuçiqi ua ka drejtuar serbëve një ditë para kalimit të afatit për draftimin e statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, duke thënë se "as këtë herë Prishtina nuk do të lëvizë as gishtin për ta formuar Asociacionin e Komunave Serbe". Ai i ka lutur qytetarët serbë të mos ndërmarrin asgjë ngaqë, sipas tij, këtë do të mund ta shfrytëzonin shqiptarët ose një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare si pretekst për të ndërmarrë çfarëdo aksioni ndaj tyre. Ai ka thënë se ruajtja e paqes në Kosovë është detyrë parësore e NATO-s prej së cilës pret dhe kërkon që ta ruajnë paqen në atë mënyrë që të pengojnë çfarëdo tentimi eventual të kujtdo dhe me çfarëdo preteksti që ta marrin dhe ta grabisin hidroelektranën 'Gazivoda' (Ujman) dhe trafo-stacionin 'Vallaç' ose cilindo objekt kyç infrastrukturor prej të cilit varet mbijetesa e serbëve.
Vuçiqi është shprehur, po ashtu, se për hir të paqes e stabilitetit do të angazhohet për zgjidhje paqësore dhe kompromisi të marrëdhënieve në Kosovë dhe nuk do të ndalet derisa serbëve të mos u sigurohen të drejta më shumë sesa që kanë sot.
Serbët kanë paralajmëruar më herët se nëse Asociacioni nuk formohet deri më 4 gusht, kur ekipi menaxhues do të duhej ta dërgojë draftin e statutit në Bruksel, atëherë ata më 5 gusht do ta shpallin vetëformimin e Asociacionit, por në formë të autonomisë.

## Ministria e Jashtme dënon gjuhën e urrejtjes antishqiptare në Maqedoni

Tiranë, 3 gusht - Ministria e Jashtme ka reaguar në lidhje me ngjarjen e ndodhur në Krushevë të Maqedonisë në një ceremoni ku u dëgjuan thirrje raciste antishqiptare. Në një deklaratë Ministra e Jashtme i dënon këto thirrje dhe shton se janë të nxitura nga ndjenja nacionaliste ekstreme. "MEPJ shpreh keqardhje dhe dënon gjuhën e urrejtjes dhe thirrjet raciste antishqiptare të hedhura të enjten gjatë ceremonisë së festimit të kryengritjes së Ilindenit në Meçkin Kamen në Krushevë. Besojmë se këto janë veprime të një grupi të vogël njerëzish të nxitur nga ndjenjat nacionaliste ekstreme dhe shpresojmë se incidente të tilla që ndjellin urrejtje ndëretnike të mbeten të izoluara. MEPJ u bënë thirrje institucioneve përgjegjëse t'i hetojnë nxitësit e dhunës dhe vendosjen e tyre para drejtësisë. Shqipëria dhe shqiptarët kanë qenë dhe do të jenë miq të përhershëm të Maqedonisë. Ne besojmë në vlerat e bashkëjetesës, në harmoninë dhe bashkëpunimin midis vendeve e qytetarëve tanë", thuhet në deklaratën e MEPJ-së.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka mbajtur të premten konferencë për medie

# Thaçi: Çështjen e korrigjimit të kufirit me Serbinë do ta paraqes në dialog

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se në procesin e dialogut me Serbinë do ta prezantojë çështjen e korrigjimit të kufirit ndërmjet dy shteteve, duke përmendur me këtë rast përfshirjen e komunave jugore të Serbisë, Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, në kuadër të territorit të Kosovës. Ai ka ftuar t'i bashkohen kësaj ideje edhe individët që po e kritikojnë për këtë kauzë. Presidenti ka treguar se shumë vende në botë kanë korrigjuar kufijtë e tyre përmes bisedimeve pa pasur nevojë të ngrehen tensione apo konflikte



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 3 GUSHT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është zotuar se në fazën finale të dialogut me Serbinë do ta paraqesë çështjen e korrigjimit të kufirit ndërmjet dy vendeve. Në një konferencë për medie të premten, ai ka thënë se korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do ta ketë mbështetjen ndërkombëtare, nëse arrihet që kjo çështje të përfshihet në marrëveshjen përfundimtare. "Institucionet tona nuk guxojnë t'i mbyllin sytë dhe ta injorojnë një mundësi të tillë historike dhe të papërsëritshme. Duhet të bashkohemi dhe t'i themi po kësaj kërkese krejt racionale, të drejtë dhe historike, e cila ka mundësi të realizohet krejtësisht në mënyrë paqësore", ka thënë Thaçi.

Ai ka sqaruar se korrigjimi i kufirit nuk do të thotë bashkim i Kosovës me Shqipërinë. "Korrigjimi i kufijve të shtetit të Kosovës me Serbinë nuk nënkupton bashkëngjitje me një shtet tjetër. Kosova është një vend i lirë, i pavarur dhe sovran dhe bashkimi më i madh i Kosovës me vendet të tjera do të ndodhë në Bashkimin Evropian", ka thënë ai.

I pari i vendit ka theksuar se procesit të bisedimeve dhe mundësisë së korrigjimit të kufijve nuk duhet t'i frikësohet askush, duke marrë shembuj të shteteve të BE-së për korrigjim të kufijve në mënyrë paqësore. Presidenti Thaçi ka treguar se shumë vende në botë kanë korrigjuar kufijtë e tyre përmes bisedimeve pa pasur nevojë të ngrehen tensione apo konflikte, duke përmendur modelin Holandë - Belgjikë.

Thaçi ka deklaruar se në rast se do të ketë sukses në këtë përpjekje, rasti i korrigjimit të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në asnjë rrethanë nuk paraqet precedent. "Anekënd botës kemi me dhjetëra raste të korrigjimit të kufirit në mënyrë paqësore. Një shembull i tillë shumë relevant i korrigjimit të kufirit ndodhi vetëm dy vjet më parë (2016) ndërmjet Holandës dhe Belgjikës. Këto dy shtete kanë arritur ta korrigjojnë kufirin e tyre në mënyrë paqësore pa pasur nevojë të shkrepin qoftë edhe një plumb të vetëm", ka theksuar Thaçi. Ai ka sqaruar se do të kihet parasysh karakteri i shoqërive shumetnike meqë kjo është vlerë thelbësore e çdo shteti demokratik. "Për më tepër, është vlerë dhe parim fondamental i BE-së. Kosova dhe Serbia duan të bëhen anëtarë të BE-së. Prandaj në çdo opsion, në rast se do të kemi marrëveshje përfundimtare, ne do të sigurohemi që kjo vlerë të ruhet dhe afirmohet", është shprehur ai.

Megjithatë, ai ka shprehur mjaft skepticizëm nëse Beogradi do ta pranonte kërkesën e tij eventuale që në tavolinën e bisedimeve të shtrohet kjo çështje. "Mundësitë janë krejt të vogla. Ka pak gjasa që Serbia të pajtohet apo aktualisht ka një refuzim kategorik. Mirëpo, unë jam zotuar se kërkesën legjitime dhe historike të qytetarëve të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit, ta prezantoj në tavolinën e dialogut", ka deklaruar presidenti, duke shtuar se reagimi i palës serbe të Beogradit do të jetë një reagim kryeneç, i rëndë dhe kategorik refuzues.

Thaçi ka mohuar edhe një herë mundësinë e ndarjes së Kosovës. Presidenti i vendit ka ftuar edhe opozitën t'i bashkohet idesë së tij për korrigjim të kufirit me Serbinë. Sipas tij, ky është moment historik që kërkon gjithëpërfshirje. "Jam i sigurt se përgjatë këtyre përpjekjeve të përbashkëta politike në kuadër të dialogut paqësor, do të bashkëngjiten edhe ata që sot hapur më kritikojnë edhe mua, edhe kauzën time për korrigjimin e kufirit me Serbinë që në mënyrë paqësore t'u mundësohet shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc realizimi i vullnetit të tyre politik, që nënkupton realizimin e ëndrrës dhe përpjekjeve të tyre shekullore", është shprehur Thaçi.

## BE-ja kërkon nga Kosova dhe Serbia të mos krijojnë tensione

Bashkimi Evropian (BE) ka kërkuar nga Prishtina dhe Beogradi që mos të ketë tensione në Kosovë, të cilat mund t'i dëmtojnë përpjekjet e përbashkëta për arritje të një marrëveshjeje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Në kohën kur të dyja palët janë plotësisht të angazhuara së bashku më përfaqësuesen e lartë të BE-së, në përcaktimin e një marrëveshjeje ligjërisht detyruese për normalizimin e plotë, BE-ja pret ashtu siç janë dekoruar të dy presidentët gjatë takimit të fundit në nivel të lartë të dialogut më 18 korrik në Bruksel, të mos ketë tensione në terren të cilat do ta rrezikojnë objektivin e përbashkët të normalizimit të marrëdhënieve", është thënë në një komunikatë për medie të Zyrës së përfaqësues së lartë të BE-së, Federica Mogherini.

Një thirrje e tillë ka ardhur pasi mediet në Kosovë dhe në Serbi janë duke raportuar për tensione të mundshme në veri të vendit gjatë fundjavës. Sipas tyre, kjo është e lidhur me dorëzimin e draftit të parë të statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe që pritet të jetë gati më 4 gusht, kur ekipi menaxhues i formuar për këtë çështje pritet ta dërgojë atë në Bruksel. "Në e kuptojmë se puna (për draftin) është duke vazhduar. Në të njëjtën kohë BE-ja vazhdon të punojë me të dyja palët për ta siguruar implementim e kësaj marrëveshje dhe të gjitha marrëveshjeve të tjera të arritura në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian", është thënë në këtë komunikatë.

Ekipi menaxhues ka pasur katër muaj kohë për draftimin e statutit të Asociacionit. Sipas BE-së, në kohën kur ky ekip e informon Brukselin për rezultatet e punës së tyre atëherë kjo do të diskutohet në takimet e nivelit të lartë në BE nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

### Lëvizja për Bashkim e përkrah idenë e ridefinimit të kufirit me Serbinë

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka përkrahur idenë e ridefinimit të kufirit me Serbinë. Në profilin e vet në "Facebook" ai ka shkruar se kufijtë aktualë të Kosovës janë kufij të kolonializmit dhe shovinizmit serbomadh. "Është për t'u çuditur për zellin që kanë një pjesë e njerëzve në Kosovë, figurave publike, politikanëve dhe gazetarëve për t'u paraqitur si mbrojtës të këtyre kufijve. Personalisht, kam frojë se krejt kjo zhurmë po bëhet që si fund të kemi një gjysmë marrëveshje, që do ta betonizonte asociacionin apo edhe ndonjë lloj autonomie të serbëve në Kosovë. Kjo do të ishte zgjidhja më e keqe e mundshme nga të gjitha variantet e që do të përpiqet të shitet si fitore e madhe për Kosovën dhe integritetin e saj territorial", ka shkruar ai, duke shtuar se do të ishte fat i madh për Kosovën nëse Lugina e Preshevës do t'i bashkohej Kosovës në këmbim të Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut. "Përndryshe, nuk do të kishte fat më të madh sesa si pjesë e marrëveshjes finale me Serbinë të ndodhte ridefinimi i kufijve me Serbinë, duke u bazuar në vullnetin e popullit shqiptar për vetëvendosje në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë si dhe të atij serb në Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok. Ky do ta përbënte hapin qenësor për shndërrimin e Kosovës në një shtet tërësisht funksional e normal dhe do ta mbyllte në mënyrë paqësore konfliktin shqiptaro-serb. Përndryshe, qëndrimi kundër idesë së reciprocitetit deri në ridefinim të kufirit është qëndrim në favor të asociacionit. E ky asociacion, së bashku me fuqinë bllokuese të serbëve në Kuvend, nesër do të na sjellë ndarjen. Pra, do ta mundësojë realizimin e plotë të synimit të Serbisë", ka shkruar Murati.

Po të premten shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka takuar kryetarin e PDSh-së, Ragmi Mustafa, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e fundit politike. Hoti e ka siguruar Mustafën se LDK-ja do t'u qëndrojë gjithmonë pranë shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc. "Grupi parlamentar i LDK-së do të luajë rol kyç në Kuvendin e Kosovës në funksion të realizimit të qëndrimit politik të LDK-së karshi çështjes së shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc", ka thënë Hoti.

Flet për "Epokën e re", Ramadan Qehaja

# Shkëmbimi i territoreve



Njohësi i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka bërë me dije se është e nevojshme marrja e masave në aspektin e sigurisë meqë, siç thotë ai, situata është e ndërlikuar. Ai ka mirëpritur rritjen e gatishmërisë së institucioneve të sigurisë në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Qehaja u ka bërë thirrje institucioneve të Republikës së Kosovës t'i ndërmarrin hapat e nevojshëm për të parandaluar çfarëdo lloj autonomie për veriun që mund ta shpallin serbët në atë pjesë. Qehaja ka folur edhe për idenë e shkëmbimit të territoreve. Ai ka pohuar se një ide e tillë është e rrezikshme në aspektin e sigurisë dhe Kosova do të dilte humbëse në këtë aspekt pasi, sipas tij, veriu për Kosovën ka një rëndësi të posaçme

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 3 GUSHT -
"Epoka e re": Z. Qehaja, të premten është mbledhur Këshilli i Sigurisë i Kosovës ku është kërkuar rritja e gatishmërisë së institucioneve të rendit dhe ligjit për ditët në vijim. Pse po ndodh ky mobilizim i sigurisë?

Qehaja: Nuk kam informacione çfarë është duke ndodhur, por në bazë të disa deklaratave dhe lëvizjeve, mund të them se situata është mjaft e ndërlikuar. Këto gjëra i kam paraparë edhe në shkrimet e mia të mëhershme të cilat, për fat të keq, nuk kanë hasur në ndonjë 'mirëkuptim'. Ndonëse jam njohës i shkëlqyeshëm i çështjeve ushtarake, policore dhe të sigurisë, askush nuk më ka konsultuar. Sidoqoftë, mbledhja e Këshillit të Sigurisë së Kosovës është e mirëseardhur meqë aty janë dhënë detyrat paraprake për rritjen e gatishmërisë vepruese të institucioneve të sigurisë. Fjala është për atë se në veri të Kosovës serbët janë përgatitur ta bëjnë njëfarë shpallje të pavarësisë apo të shkëputjes së tyre nga territori i Republikës së Kosovës. Mirëpo kjo nuk do të thotë asgjë, sepse në bazë të Kushtetutës së Kosovës askush nuk ka të drejtë ta bëjë një veprim të tillë. Edhe nëse bëhet ky veprim do të kishte me qenë baras me zero sa i përket zbatimit në praktikë. Do të thotë, nuk mund të zbatohet sepse Kushtetuta nuk e lejon një gjë të tillë. Mirëpo mendoj se masat e sigurisë që janë ndërmarrë në këtë drejtim janë të nevojshme.

**"Epoka e re":** *Ka rrezik për destabilizim të situatës së sigurisë?*

**Qehaja:** Ka rrezikshmëri sepse shpallja e një autonomie do ta përcillte një destabilizim apo përdorim të forcave dhe mjeteve në pjesën veriore të Kosovës dhe në një moment do të bëhet shkëputja apo aneksimi i territorit siç ka qenë principi i aneksimit të Krimesë, edhe pse Kosova me Krimenë nuk mund të krahasohet, por veprimet që mendohet të ndërmerren janë në këtë drejtim. Prandaj në situatën e tanishme duhet të lihen deklaratat boshe dhe të veprojmë konkretisht me ushtri, me polici dhe me institucione të tjera dhe ta ngrehim gatishmërinë luftarake deri në atë masë saqë të jemi të gatshëm të veprojmë. Kuptohet se për të vepruar në pjesën veriore të Kosovës është përgjegjës KFOR-i, përkatësisht NATO-ja. Njësitet e KFOR-it duhet të ballafaqohen që mos të lejojnë asnjë lloj ndërhyrje të forcave ushtarake dhe policore të Serbisë në atë pjesë të territorit tonë.

**"Epoka e re":** *Si duhet të veprojnë institucionet e Republikës karshi këtyre zhvillimeve?*

**Qehaja:** Në rast se do të ketë shpallje të autonomisë të veriut nuk do të ketë jetësim të saj, sepse Kushtetua e Kosovës nuk e lejon. Megjithatë, efekti politik do të kishte me qenë mjaft i theksuar, prandaj duhet shpjeguar popullatës se kjo çon në destabilizim të vendit.

**"Epoka e re":** *Edhe Policia e Kosovës me një urdhër operativ ua ka ndërprerë shkuarjen në pushim pjesëtarëve të uniformuar. Është kjo një parapërgatitje për parandalimin e shkëputjes së veriut?*

**Qehaja:** Kuptohet se po. Nuk mund të jemi indiferentë kur bëhet fjalë për rrezikimin e integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Jemi dëshmitar se deri më tani jemi ballafaquar me situata të llojllojshme në veri por, sidoqoftë, para këtyre bisedimeve që do

# sjell rrezikshmëri



të pasonin, kjo situatë është mjaft e ndërlikuar dhe serbët janë të përgatitur ta shpallin autonominë. Secili qytetar duhet ta kryejë detyrën e vet me përkushtim dhe duhet ta japë kontributin në mbrojtje të territorit të Republikës së Kosovës.

**"Epoka e re":** *Presidenti Thaçi ka paralajmëruar se faza finale e dialogut do të jetë e vështirë. Kjo deklaratë e tij nënkupton se shkëputja e veriut nga Kosova do të jetë pjesë e marrëveshjes përfundimtare të dialogut?*

**Qehaja:** Negociatat në mes të Prishtinës dhe Beogradit janë duke u zhvilluar që gjashtë apo shtatë vjet, por nuk kanë dhënë ndonjë efekt të madh, përveç kalimit të aty-këtushëm të qytetarëve të Kosovës në Serbi. Serbia nuk u është përmbajtur zotimeve, prandaj kemi edhe shumë probleme në këtë drejtim. Nuk duhet të lejojmë që të ndodhë një gjë e tillë. FSK-në nuk duhet ta lëmë anash sepse duhet të përgatitet për detyrat e veta të gatishmërisë emergjente ashtu siç i ka. Mendoj se është momenti i volitshëm që me një ligj të ngutshëm që ka të bëjë me kompetencat që mund t'i marrë në aspektin ushtarak, kjo forcë duhet të kalojë në Kuvend dhe t'i jepen detyrat që duhet t'i kryejë - edhe ushtarake në momentin aktual në lëvizje e sipër. Edhe pse nuk është e përgatitur në masë të duhur për këtë, FSK-ja është një këmbësori e nivelit bukur të lartë aktualisht.

**"Epoka e re":** *Mund ta parandaloj Kosova shpalljen e autonomisë së veriut?*

**Qehaja:** Kosova duhet ta pamundësojë një gjë të tillë, por nëse veç ndodh autonomia, nuk duhet lejuar jetësimi i saj. Jetësimi i autonomisë bëhet me aneksimin e territorit dhe për të aneksuar atë pjesë të territorit duhet të veprohet me forca të sigurisë të Serbisë në territorin tonë dhe këtë ne nuk do ta lejojmë. Këtë nuk do ta lejojë as KFOR-i e as NATO-ja. Mirëpo sikur ne që jemi në gjendje ta mbrojmë territorin e Republikës së Kosovës askush nuk do të jetë në gjendje ta mbrojë. Në aspektin politiko-diplomatik duhet të veprohet menjëherë dhe nëse ka elemente të bollshme që tregojnë se është e mundshme shpallja e autonomisë të veriut atëherë në arenën ndërkombëtare duhet thënë se Serbia po e destabilizon situatën në Ballkanin Perëndimor. Në aspektin praktiko-profesional duhet të ndërmerren masat nga institucionet e sigurisë, që të jenë në gatishmëri për ta mbrojtur çdo pëllëmbë të territorit.

**"Epoka e re":** *Këto ditë opinioni publik është përballur me deklarata të shumta rreth mundësisë për shkëmbim të territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Mund të kenë pasoja në aspektin e sigurisë?*

**Qehaja:** Nuk jam për shkëmbim të territoreve sepse situata do të ishte shumë e rrezikshme në aspektin e sigurisë dhe do të ishim humbës. Veriu për Kosovën ka një rëndësi të posaçme. Diku 12 deri në 13 për qind e nëntokës së territorit është me xehe dhe ka infrastrukturë për përpunimin e tyre. Po ashtu, është territor i pasur me ujë. Rreth 75 e Ujmanit i takon Kosovës. Gjithashtu, në aspektin ushtarak ky territor ka rëndësi të posaçme sepse kanalizon drejtimet ku me forca dhe mjete shumë të vogla kemi mundësi t'i mbrojmë drejtimet e duhura në rast se do të depërtonin forcat të cilat do të përgatiteshin për një sulm në territorin tonë. Është një tërësi topografike e rëndësishme ushtarake që mundëson mbrojtje me forca dhe mjete të vogla të këmbësorisë, duke e organizuar sistemin e zjarrit dhe duke mos lejuar që forcat të depërtonin në brendi të territorit të Republikës së Kosovës. Prandaj nuk duhet lejuar që ky territor të dalë nga kompetenca jonë, sepse është i shtetit të Kosovës. Në anën tjetër, kur është fjala për Luginën e Preshevës, të jeni të bindur se Serbia nuk do të japë atë pjesë në asnjë mënyrë. Ata do të mund të na jepnin fshatrat rreth vijës kufitare, por jo territorin e tërësishëm që ka Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, sepse ky do të ishte hendikep i madh për Serbinë së cilës i mbyllet dalja në luginën e Vardarit. Shkëmbimi i territoreve do të sjellë rrezikshmëri në aspektin e sigurisë. Do të ngrehën tensionet dhe do të ketë lëvizje të popullatës. Kjo temë nuk duhet të trajtohet në atë mënyrë siç mendojnë disa politikanë se mund të trajtohet. Tërësia territoriale e Republikës së Kosovës është e pacenueshme dhe askush nuk guxon ta lëvizë asnjë pjesë të saj, sepse këtë nuk e lejon populli i Kosovës dhe gjaku i derdhur.

## Limaj: Deklarimet për korrigjim të kufijve, të papranueshme

Prishtinë, 3 gusht - Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se deklarimet për korrigjim të kufijve nga bartësit e institucioneve janë të papranueshme. "Kemi obligim ta respektojmë Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe deklarimet për korrigjim të kufijve nga bartësit e institucioneve janë të papranueshme", ka thënë Limaj në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë". Ai ka theksuar se në Kosovë kurrë nuk do të ketë Republika Serbe dhe diçka e tillë pasi, sipas tij, kjo do ta rrënonte e shkatërronte Kosovën. Duke folur rreth temës së dialogut Kosovë - Serbi, Limaj i ka bërë thirrje opozitës të jetë pjesë e këtij procesi.

Ndërsa në pyetjen nëse është i mendimit që opozitës do të duhej t'i jepet një rol prijës në dialog, Limaj ka dhënë këtë përgjigje: "Ajo që mua më intereson është që të gjithë duhet të marrim përgjegjësi. Nuk mund që dikush të qëndrojë duke vëzhguar dhe të bëjë me gisht, e dikush të marrë përgjegjësi sepse tema që do të vendosë njëherë e përgjithmonë të ardhmen dhe fatin e këtij vendi nuk është e brendshme. Prandaj, e rëndësishme është që të gjithë të jemi të përfshirë, pastaj duhet të bëhet grupi. Kushdo që do të udhëheqë nga ne, pse të mos e ketë rolin prijës njëri nga grupet parlamentare ose nga drejtuesit e grupeve parlamentare. Këto çështje të gjitha duhen hapur, duhen diskutuar dhe të diskutohet për të gjitha variantet ose mënyrat se si i shikojnë grupet politike. Siç thashë, kemi prodhuar lloj-lloj dokumentesh. Të ulemi, t'i shikojmë ato dokumente, ta gjejmë zgjidhjen ose formulën që na bashkon të gjithëve. Pra, ne jemi vonë realisht, por do të thosha se kemi ende kohë për ta bërë. E rëndësishme është se nuk bën të nxitojmë dhe të futemi në një dialog pa u përgatitur e të përçarë".





# Berisha: FSK-ja është e gatshme për transformim në Forca të Armatosura

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 GUSHT - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, ka bërë me dije të premten se FSK-ja është e gatshme për marrjen e detyrave dhe përgjegjësive shtesë, që çojnë në transformimin e saj në Forca të Armatosura të Kosovës. Këtë deklaratë ministri Berisha e ka dhënë gjatë një takimi me shefin e Byrosë së Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjeneralin Joseph L. Lengyel, bashkë me një delegacion të ushtarakëve amerikanë.

Në këtë takim, siç ka njoftuar MFSK-ja, është biseduar për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Ata shprehen vendosmërinë për ta ngritur në nivel edhe më të lartë bashkëpunimin në mes dy vendeve në të ardhmen.

Ministri Berisha, pasi ka falënderuar gjeneralin amerikan për mbështetjen e vazhdueshme dhe të çmueshme, ka folur edhe mbi zhvillimet, avancimin dhe të arriturat e FSK-së si institucioni më i besueshëm i sigurisë në vend, integrimin e pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve në FSK, integrimin e gjinisë femërore, trajnimet, shkollimet dhe operacionet humanitare në të mirë të komunitetit si dhe për çështje të tjera.

Gjithashtu, ministri Berisha në takim ka theksuar synimin e Republikës së Kosovës për anëtarësim në NATO dhe në iniciativat rajonale të sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe gatishmërinë e



Kosovës për t'i kontribuar paqes dhe sigurisë në botë, duke potencuar se FSK-ja ka kapacitete të specializuara me të cilat do të mund t'i ndihmonte misionet paqësore jashtë vendit.

Gjenerali Lengeyl ka thënë se do ta vazhdojnë rritjen e mëtutjeshme të miqësisë në mes dy vendeve. "Është prioritet yni strategjik që të jemi bashkë me ju. Dua t'ju përgëzoj, në veçanti për gatishmërinë tuaj për t'i kontribuar paqes", ka thënë gjenerali amerikan Joseph L. Lengyel. Gjenerali Lengeyl është pritur në takim edhe nga komandanti i FSK-së, Rrahman Rama.




# Doris Pack e nderon Adem Demaçin

PRISHTINË, 3 GUSHT - Doris Pack, politikane gjermane e CDU-së, partisë së kancelares së Gjermanisë, Angela Merkel, ish-deputete e Parlamentit Evropian nga viti 1989 deri në vitin 2014, ka qëndruar në vizitë për ngushëllime në familjen e ikonës së rezistencës dhe luftës së Kosovës për liri, Adem Demaçi, duke e nderuar kështu përpjekjen dhe sakrificën e Demaçit në shërbim të lirisë, të drejtave njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve. Me këtë rast, i biri i Demaçit, Shqiptari, i ka dhuruar ish-eurodeputetes kompletin e krijimtarisë letrare të Adem Demaçit.

# Veseli pret bashkatdhetarët në Kuvend

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, e ka filluar ditën e premte duke pritur bashkatdhetarët nga diaspora në zyrën e tij në Kuvend. Gjatë takimit me bashkatdhetarë, përveç diskutimeve për të arriturat e shtetit të Kosovës, kryeparlamentari Veseli është parë duke kaluar edhe çaste relaksimi me ta.

Nëpërmjet një statusi në faqen e tij në "Facebook", Veseli ka vlerësuar lart rolin e qytetarëve të Kosovës që jetojnë në diasporë. "Kuvendi i Kosovës ka hapur dyert për bashkatdhetarët tanë që jetojnë në diasporë. Sot e nisa ditën e punës duke takuar shumë prej tyre. Gjithmonë është kënaqësi takimi e bashkëbisedimi me njerëzit tanë që jetojnë e punojnë në diasporë. Liria e Kosovës, shteti ynë i pavarur dhe sovran, ekonomia jonë familjare e nacionale, e mbajnë vulën e kontributit të tyre të jashtëzakonshëm. Diaspora jonë është leksioni më i mirë se çfarë mrekullie mund të bëjë dashuria për atdheun", ka shkruar Veseli.



# ShSKUK-ja për gjashtë muaj ofroi gjashtë milionë shërbime shëndetësore

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK), Basri Sejdiu, para anëtarëve të bordit drejtues të këtij shërbimi ka paraqitur raportin gjashtëmujor të vitit 2018. Duke prezantuar statistikat e punës, Sejdiu ka njoftuar anëtarët e bordit drejtues se në periudhën janar - qershor të këtij viti janë ofruar 3.6 milionë shërbime, 444 mijë ditë shërimi. Po ashtu, ai ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe në ShSKUK kanë qenë të shtrirë 83 mijë pacientë. Më tutje, ai ka bërë me dije se për gjashtë muaj janë kryer 21 mijë operacione dhe janë ofruar 675 mijë shërbime ambulantore.

Sejdiu ka thënë se në këtë periudhë kohore janë ofruar 1.4 milion shërbime (parametra) laboratorike për 247 mijë pacientë. Gjatë periudhës janar - qershor kanë ndodhur 10 886 lindje, 61 893 shërbime të dializës, janë kryer 647 stentime, 1 159 koronarografi dhe 104 operacione kardiokirurgjike.



Mbahet takimi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës

# Haradinaj kërkon rritjen e shkallës së gatishmërisë në vend

Kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar të premten rritjen e gatishmërisë së institucioneve të rendit dhe ligjit në ditët që vijnë. Ai pas takimit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës ka bërë me dije se këtë gjë e ka kërkuar në rast të çfarëdo prishjeje të rendit dhe ligjit që mund të paraqitet. Sipas Haradinajt, është konstatuar se disa persona të dyshimtë qarkullojnë në pjesën veriore dhe ata mund të jenë nga Republika Serpska ose pjesë të tjera



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thirrur të premten në takim Këshillin e Sigurisë së Kosovës për të diskutuar për gjendjen e rendit dhe ligjit dhe sigurisë në vend. Pas këtij takimi ai ka mbajtur një konferencë për media, në të cilën ka folur rreth këtij takimi dhe temave të tjera që e presin vendin. "Ishte temë e ditës gjendja e rendit dhe ligjit dhe sigurisë në vend, si dhe reflektimi i retorikës së fundit politike që ka ndodhur, pastaj reflektimi i afateve kohore që lidhen me asociacionin, por edhe informatave të tjera që lidhen me rendin dhe ligjin dhe sigurinë në vend. E vërteta është se kam kërkuar rritjen e gatishmërisë së institucioneve të rendit dhe ligjit në gjithë vendin, në mënyrë që të sigurojmë rend dhe ligj, qetësi në gjithë vendin në ditët që vijnë", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se me këtë nënkupton që gjendja në rend dhe ligj dhe siguria në vend është e qetë, por se është kërkuar rritja e gatishmërisë për veprim në rast të çfarëdo prishje të rendit dhe ligjit në vend.

Kryeministri Haradinaj ka shtuar se retorika për kufijtë ose për territorin në Kosovë është kundërreagim i një retorike që vjen nga Beogradi, gjoja për të drejtat e Serbisë në Kosovë, më konkretisht për veriun. "Kjo retorikë nuk e ka qëllimin e prishjes së rendit dhe ligjit dhe sigurisë në Kosovë. As serbët e Kosovës, as komunitetet e tjera, por as shqiptarët nuk duhet të ndihen të rrezikuar. Është retorikë politike, publike, kundërretorikë e një retorike që vjen", ka vlerësuar kryeministri Haradinaj.

Sa i përket Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, Haradinaj ka thënë se Kosova është brenda obligimeve të veta, që nënkupton se më 4 gusht është afati kur dorëzohet transkriptimi i grupit punues për draftstatutin, duke shtuar se kjo është dinamika kohore dhe se procedura nga marrëveshjet në Bruksel parasheh që kjo të bëhet para palëve, në këtë rast edhe para BE-së, edhe para palës serbe, edhe para palës së Kosovës, në këtë rast shefit të negociatave. "Ne qëndrojmë brenda obligimeve. Nuk kemi dalë nga obligimet qofshin në dialog, pra nga obligimet në Bruksel, por as nga Kushtetuta dhe ligjet tona. Kështu që, kur e marrim transkriptimin japim kontributin tonë, por edhe duhet të sigurohemi që është brenda ligjeve dhe Kushtetutës së vendit. Me këtë po dua të them se Kosova si palë është serioze, është brenda obligimeve ndërkombëtare dhe vendore. Për këtë askush nuk e ka të drejtën të ndërmarrë veprime të njëanshme. Pse? Sepse asnjë thyerje, asnjë dalje nga obligimet nuk ka bërë Kosova", ka shtuar kryeministri Haradinaj, duke sqaruar se nëse dikush do të merrte ndonjë veprim të njëanshëm, atëherë ai veprim është jashtë ligjeve të Kosovës, edhe jashtë marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ai veprim do ta merrte përgjigjen e organeve të rendit dhe të ligjit.

Kryeministri Haradinaj ka theksuar se Kosova është brenda marrëveshjes ndërkombëtare, duke ritheksuar se ka respektuar obligimin e marrëveshjes ndërkombëtare dhe Brukselin. "Kosova respekton ligjet e veta dhe kushtetutën e vet dhe nëse dikush del jashtë kësaj, atëherë ligji do të veprojë me seriozitetin e vet, e këtu nuk ka dilemë, e nëse dikush ka dilema këtu gabohet, pra do ta marrë përgjigjen e vet", është shprehur Haradinaj.

Ndërsa sa iu përket personave të caktuar të dyshimtë, që është konstatuar se qarkullojnë në veri dhe të cilët mund të jenë nga Republika Serpska ose nga zonat e tjera, kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosova çdoherë ka mirëpritur ardhjen e të gjithë qytetarëve të lirë të botës te ne dhe janë të mirëpritur në çdo pjesë të Kosovës. "Procedurat e udhëtimit e dimë si shkojnë, por nuk kemi shprehur ndonjë paragjykim, kushdo që hyn brenda territorit të Kosovës me qëllim të shkaktimit të ndonjë incidenti, prishjes së rendit dhe të ligjit, normalisht se do ta marrë reagimin e institucioneve të rendit dhe të ligjit. Këtu s'do të ketë dilema", ka thënë Haradinaj.

Në fund të konferencës për medie, kryeministri Haradinaj ka ripërsëritur faktin se rritja e shkallës së gatishmërisë në vend nuk është urdhër për veprim, por fakt se institucionet e Kosovës në gjendje gatishmërie dhe në rast se ka prishje të rendit dhe të ligjit do të veprojnë.

# Dorëzohen 82 kallëzime penale për krime lufte në Kosovë



PRISHTINË, 3 GUSHT - Përfaqësuesit e grupit të shoqërisë civile për grumbullimin e dëshmive për krime lufte kanë dorëzuar të premten 82 kallëzime penale në Prokurorinë Speciale të Kosovës, në Departamentin për Krime të Rënda.

Kryetarja e këtij grupi, Mevlyde Mezini-Saraqi, ka thënë se ky është kontingjenti i gjashtë me kallëzime penale që u dorëzohet institucioneve të drejtësisë. "Sot e dorëzuam kontingjentin e gjashtë, që përbëhet prej 82 kallëzimeve penale, kundër kriminelëve serbë të cilët kanë kryer krime lufte kundër popullatës së Gjakovës. Këto kallëzime penale janë të përmbushura me dëshmi, me fotografi, me fakte, me deklarata, me shkrime dhe dokumente përcjellëse", ka thënë Mezini-Saraqi.

Ajo ka shtuar se shpreson që kësaj radhe institucionet e vendit do të merren me këto dëshmi të ofruara dhe këto dokumente të mos mbeten, siç u shpreh ajo, "në sirtarë". "Shpresojmë që kësaj radhe kallëzimet penale nuk do të mbesin nëpër sirtarë, siç ka ndodhur më parë në kohën e UNMIK-ut dhe të EULEX-it, por shumë besojmë në shtetin e Kosovës, në drejtësinë e pavarur e cila e ka për obligim t'i kryejë të gjitha rastet me nder dhe kriminelët e vërtetë të dënohen", ka thënë Mezini-Saraqi.

Ka qenë fillimisht administrata e Kombeve të Bashkuara - UNMIK - që është marrë me rastet e krimeve të luftës në Kosovë, më pas me këto raste është marrë misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit - EULEX. Nga 30 qershori, EULEX-i ka transferuar kompetencat tek institucionet përgjegjëse të Kosovës.

# Ministria e Infrastrukturës do ta menaxhojë zyrën për monitorimin e të drejtave të pasagjerëve

EPOKA E RE A. MAVRAJ

**Prishtinë, 3 gusht** - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka vizituar të premten Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", ku është pritur në takim nga anëtari i bordit të drejtorëve dhe kryeshefi ekzekutiv i këtij aeroporti, Haldun Firat Kokturk, me të cilin ka biseduar për mundësitë e avancimit të shërbimeve për pasagjerët. Gjatë kësaj vizite Lekaj dhe Kokturk kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, me ç'rast ministrit të Infrastrukturës i janë dorëzuar çelësat e zyrës për monitorimin e të drejtave të pasagjerëve, e cila tash e tutje do të jetë në shfrytëzim të kësaj ministrie, respektivisht nga Departamenti i Aviacionit Civil.

Ministri Lekaj, duke e falënderuar kryeshefin Kokturk për bashkëpunimin e vazhdueshëm, ka thënë se me vendosjen e zyrtarëve të Ministrisë së Infrastrukturës në ambientet e aeroportit, qytetarët do të kenë mundësi t'i parashtrojnë ankesat dhe do të udhëzohen nga kjo zyrë në lidhje me të drejtat e tyre që u takojnë. Më tutje, Lekaj e ka përgëzuar menaxhmentin e ANP "Adem Jashari" për rritjen e numrit të pasagjerëve për 15 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Ai ka thënë se ky rezultat jep mesazhin që ANP "Adem Jashari" është qendër e pasagjerëve që e lidhë Prishtinën me botën.

Lidhur me mashtrimet e pasagjerëve nga persona dhe kompani të ndryshme, Lekaj ka thënë se kjo dukuri është reduktuar në mënyrë drastike krahasuar me vitet e kaluara. Ndërsa kryeshefi ekzekutiv i ANP "Adem Jashari", Haldun Firat Kokturk, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes dhe dorëzimit të çelësave të zyrës tek ministri Lekaj ka deklaruar se rritja për 14.5 për qind e numrit të pasagjerëve tregon se ky vit ka qenë goxha i ngarkuar për këtë aeroport.



# Ministri i Infrastrukturës përkrah dy projekte në Zubin Potok



**Prishtinë, 3 gusht (ER)** - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka pritur të premten në takim kryetarin e Zubin Potokut, Stevan Vulkoviq, me të cilin ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për dy projekte të kësaj komune. Vlera e këtyre dy projekteve është 626 mijë euro dhe ato janë të rëndësishme për zhvillim ekonomik dhe të turizmit të kësaj ane, njëkohësisht edhe për lëvizje të lirë dhe pa pengesa për të gjithë qytetarët tanë. Lekaj ka thënë se qëllimi i këtij memorandumi është financimi i këtyre dy projekteve infrastrukturore, të komunës së Zubin Potokut, që do të ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe se çfarëdo kërkese nga kjo komunë për projekte infrastrukturore, por edhe për projekte të tjera, do ta kenë mbështetjen e tij.

Ministri Lekaj ka theksuar se Qeveria e Kosovës dhe ai si ministër i Infrastrukturës mbeten të përkushtuar për ushtrimin e pushtetit dhe ndarjen e buxhetit në të gjitha komunat e vendit pa dallim, në mënyrë që të gjithë qytetarët e vendit tonë të jenë përfitues të investimeve. Ndërkaq kryetari i Zubin Potokut, Stevan Vulkoviq, ka thënë se këto dy projekte do të jenë ndihmesë e madhe për qytetarët e komunës së tij dhe për zhvillim edhe më të madh të turizmit në këtë komunë.

## Nënshkruhet memorandumi për ndërtimin e rrugës në Gjurgjevik

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, bashkë me ministrin e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha dhe në harmoni të plotë me kërkesat e qytetarëve të Gjurgjevikut të Madh, të shprehura përmes kryetarit të Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, nënshkruan të premten memorandumin e mirëkuptimit si tri institucione, për ta ndërtuar rrugën në fshatin Gjurgjevik të Madh të Komunës së Klinës."Kjo rrugë do të ndërtohet me ndihmën reciproke të Ministrisë së FSK-së, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Klinës. Kështu do t'i ofrohet mundësia këtij fshati të ketë lidhje më të shpejtë me fshatrat përreth dhe qytetin e Klinës. Gjithashtu, kjo do të jetë edhe një mundësi e mirë për t'u zhvilluar pjesët piktoreske të kësaj ane", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës.

# Serbia nuk po e respekton marrëveshjen për energjinë

**Prishtinë, 3 gusht (ER)** - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka pritur të premten në takim përfaqësuesit e Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë (ENTSO-E), Peter Hoffmann dhe Laurent Rosseel, të cilët janë duke qëndruar në Kosovë në kuadër të një misioni faktmbledhës lidhur me problemet që ka vendi ynë për faturimin dhe furnizimin e energjisë elektrike në veri. Lluka ka thënë se Kosova është e interesuar për implementimin e marrëveshjes së Brukselit për energji, por është pala serbe që me vite është duke bërë obstruksione në raport me obligimet që dalin nga kjo marrëveshje.

Ai ka thënë se moszbatimi i kësaj marrëveshje është duke i shkaktuar KOSTT-it humbje financiare dhe probleme teknike. "Pavarësisht prej bllokadave të shumta nga Serbia, jemi duke i zbatuar kërkesat që dalin nga pakoja e tretë e ligjeve për energji në lidhje me hapjen e tregut dhe integrimit drejt një tregu regjional te energjisë", ka thënë Lluka.

Ministri Lluka shpreson që ENTSO-E do t'i ndihmojë në këtë proces duke llogaritur që KOSTT-i ka dëshmuar teknikisht edhe pse i plotëson kriteret për të operuar si zonë e pavarur rregulluese dhe të qenit anëtar i ENTSO-E.



# Kosova rrezikon t'i humbë rreth 80 milionë eurove të BE-së

Hulumtuesja në Institutin GAP, Nora Jusufi, në një konferencë për media me temën "Monitorimi i realizimit të objektivave nga Agjenda për Reforma Evropiane (ERA)", ka shprehur shqetësimin se Kosova është duke ngecur sa i përket realizimit të objektivave që dalin nga agjenda evropiane, ku përfitimi do të jetë deri në 80 milionë euro




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 GUSHT - Instituti GAP, Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS) kanë mbajtur të premten konferencë për media me temë "Monitorimi i realizimit të objektivave nga Agjenda për Reforma Evropiane (ERA)". Në këtë konferencë u prezantuan të gjeturat nga monitorimi i obligimeve të mbetura dhe të parapara që të finalizohen gjatë vitit 2018, sipas vendimit të mbledhjes së trembëdhjetë të Qeverisë së Kosovës që u mbajt në nëntor të vitit të kaluar.

Prioritetet kyçe të Agjendës për Reforma Evropiane ndahen në tri shtylla kryesore: qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, konkurrueshmëria dhe klima e investimeve dhe punësimi dhe arsimi.

Njomza Mjeku, zyrtare e projekteve në GLPS, ka thënë se në fushën e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit janë identifikuar 11 masa dhe 36 veprime përkatëse, prej të cilave 23 veprime janë plotësuar në tërësi, katër veprime janë realizuar pjesërisht, tri veprime mbesin të paplotësuara dhe gjashtë veprime janë paraparë të plotësohen në gjashtëmujorin e dytë të këtij viti. Ajo ka shtuar se disa nga veprimet të cilat kanë ngecje dhe mbesin ende në proces janë: miratimi i legjislacionit për pezullimin e zyrtarëve publikë në raste korrupsioni, miratimi i ligjit për gjyqtarë dhe prokurorë, miratimi i pakos ligjore për reformën e administratës publike dhe pakos ligjore për reformën zgjedhore.

Nora Jusufi, hulumtuese në Institutin GAP, ka thënë se në fushën e konkurrueshmërisë dhe klimës së investimeve janë gjithsejtë 12 masa dhe 44 veprime prej të cilave, 17 veprime janë plotësuar në tërësi, pesë veprime janë realizuar pjesërisht, gjashtë veprime mbesin të paplotësuara dhe 16 veprime janë paraparë të plotësohen në gjashtëmujorin e dytë të këtij viti. Ajo ka thënë se disa nga objektivat që kanë progres, por që nuk janë përmbushur në tërësi, janë ristrukturimi i KIESA-s, miratimi i ligjit për efiçiencë të energjisë, krijimi i fondit gjegjës, si dhe zbatimi i masave të buta në kuadër të agjendës së inter-konvektivitetit për shkak të moszbatimit të marrëveshjeve nga të gjitha palët nënshkruese.

Jusufi ka thënë se këto ngecje rrezikojnë humbjen e fondeve për rreth 80 milionë euro nga MSA-ja dhe integrimin në BE.

Visar Xhambazi, hulumtues në PIPS, ka deklaruar se në fushën e punësimit dhe arsimit nga gjashtë masa dhe 27 veprime përkatëse të kësaj fushe, gjashtë veprime janë plotësuar në tërësi, 10 veprime janë realizuar pjesërisht, gjashtë veprime mbesin të paplotësuara dhe pesë veprime janë paraparë të përfundojnë deri në fund të vitit. Ai ka thënë se disa nga ngecjet e objektivave në këtë fushë ndërlidhen me miratimin e rregulloreve të punës për Agjencinë e Punësimit, ndarja e buxhetit të duhur për implementimin e planit strategjik për arsim, themelimi i agjencisë për kurrikulë, standarde dhe vlerësim, si dhe hartimi i kurrikulave bërthamë për arsimin dhe aftësimin profesional.

Plani i veprimit të zbatimit të ERA-s për vitin 2018 përfshinë 29 masa të përgjithshme të cilat zbërthehen në 107 veprime konkrete, prej të cilave për këtë periudhë vetëm 42.99 për qind janë përmbushur plotësisht, 17.76 për qind janë përmbushur pjesërisht dhe 14.02 për qind nuk janë përmbushur fare, ndërsa 25.23 për qind pritet të përfundojnë gjatë periudhës korrik-dhjetor 2018.

# Jagxhillari kërkon zbatimin e strategjisë për modernizimin e administratës publike



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 GUSHT - Ministria e Administratës Publike (MAP) ka finalizuar procesin e hartimit të planit të veprimit për zbatimin e strategjisë për modernizimin e administratës publike. Plani ka kaluar edhe fazën e konsultimeve publike dhe ndërministrore dhe në ditët në ardhshme pritet miratimi nga Qeveria e Kosovës.

Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike (SMPA) 2015-2020 përqendrohet në arritjen e rezultateve për sa i përket shërbimit civil, menaxhimit të burimeve njerëzore, ofrimit të shërbimeve publike administrative dhe llogaridhënien në administratën publike. Me qëllim që të ketë koordinim më të madh të institucioneve për zbatimin e Planit të Veprimit për SMAP, MAP-i ka organizuar të premten një takim pune me aktorët kryesorë institucionalë, për të diskutuar për objektivat, treguesit dhe aktivitetet e planit të veprimit, në mënyrë që secili institucion ta ketë të qartë përgjegjësinë që ka në kuadër të planit të veprimit.

Në këtë takim ministri i Ministrisë së Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, ka kërkuar mobilizim më të madh të institucioneve për zbatimin e Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike. Gjatë takimit u diskutua edhe për komentet e Komisionit Evropian për raportet e zbatimit të strategjive kornizë për reformën e administratës publike dhe u dakordua që Sekretariati për Reformën e Administratës Publike do të punojë me një grup të ekspertëve për të siguruar se komentet janë adresuar.

Jagxhillari gjatë këtij takimi ka theksuar se zbatimi i strategjisë për modernizimin e administratës publike ka për qëllim të krijojë kushte që administrata shtetërore e Republikës së Kosovës të jetë e orientuar kah plotësimi i kërkesave dhe nevojave specifike të qytetarëve dhe bizneseve dhe që të punojë në interes të tyre. Ai ka thënë se synimet e Ministrisë së Administratës Publike janë që të reduktohen barrierat procedurale dhe administrative, të ulet kostoja dhe koha e shpenzuar gjatë marrjes së shërbimeve publike administrative nga ana e qytetarëve.

## Selim Pacolli inspekton punimet për rregullimin e shkallëve në lagjen "Arbëria"



PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, së bashku me drejtorin e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Gëzim Mehmeti, kanë inspektuar të premten punimet në rregullimin e shkallëve të lagjes "Arbëria" në kryeqytet. Punimet e vrazhda dhe instalimet nëntokësore të këtyre shkallëve kanë përfunduar dhe tani pritet të fillojnë punët montuese.

# Përkujtohet dëshmori Zenel Mziu



SKENDERAJ, 3 GUSHT (ER) - Në sallën e Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina" në Skenderaj të premten është mbajtur akademi përkujtimore në nderim të dëshmorit të kombit Zenel Mziu, me rastin e 20-vjetorit të rënies heroike të tij. Nën organizimin e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së në nivelin qendror, në këtë akademi, përveç familjarëve, kanë marrë pjesë një numër i madh i qytetarëve, bashkëluftëtarëve të dëshmorit Mziu, deputetë të Kuvendit të Kosovës, ushtarakë të lartë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, zyrtarë të lartë të Qeverisë së Kosovës etj.
Në emër të Komunës së Skenderajt ka folur Ramiz Shala, drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, i cili ka lartësuar veprën dhe sakrificën e dëshmorit Zenel Mziu.
Vëllai i dëshmorit, Besim Mziu, ka theksuar se pa gjakun e dëshmorëve të Kosovës nuk do të ekzistonte ndoshta as jeta jonë dhe as fjala e lirë shqipe. "Ne së bashku me ju do t'i kujtojmë gjithmonë heronjtë dhe dëshmorët e rënë dhe do t'i ruajmë kujtimet e mira për ta", është shprehur vëllai i dëshmorit të kombit, Mziu.
Familja e dëshmorit Mziu ka pranuar edhe Urdhrin "Hero i Kosovës" nga presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi.

# Bahtiri kërkon përkushtim në punë nga administrata e komunës



MITROVICË, 3 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka mbajtur një takim me të gjithë shërbyesit civilë të administratës komunale, në të cilin ishin të pranishëm edhe drejtorët e drejtorive komunale. Ai i ka njoftuar të pranishmit se e ka suspenduar një shërbyes civil në shërbimin e ofiqarisë për shkak se është arrestuar nga Policia e Kosovës, si i dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare, përkatësisht shkelje të dispozitave ligjore.
Bahtiri ka theksuar se duke qenë se shkelja e supozuar e shërbyesit të arrestuar nga policia paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës, suspendimi i shërbyesit civil të administratës komunale do të zgjasë derisa organet e hetuesisë dhe drejtësisë ta thonë fjalën e tyre përfundimtare. "Në administratën komunale të Mitrovicës nuk mund të ketë vend për shërbyes civilë të pandërgjegjshëm, shërbyes civilë që shkelin ligjin dhe normat e punës, shërbyes civilë që nuk e respektojnë qytetarin. Administrata është për qytetarë dhe të gjithë shërbyesit civilë janë në shërbim të qytetarëve. Ndaj të gjithë atyre që nuk janë të përkushtuar për punë dhe që nuk e respektojnë ligjin dhe qytetarin do të merren masa disiplinore", u ka thënë Bahtiri shërbyesve civilë dhe drejtorëve të drejtorive komunale.

# Nisin punimet në realizimin e projektit 'Shtigjet e ecjes' në Rahovec



RAHOVEC, 3 GUSHT (ER) - Kanë nisur punimet në realizimin e njërit ndër projektet me më interes për qytetarët e Komunës së Rahovecit "Shtigjet e ecjes". Në fillimin e punimeve i pranishëm ishte edhe kryetari i komunës, Smajl Latifi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët. Pas fillimit të punimeve kryetari Latifi ka thënë se sot po nisin punimet për realizimin e projektit "Shtigjet e ecjes", projekt ky shumë i rëndësishëm dhe në vendin e veçantë, nën "Majën e Shkodranit". Sipas tij, kjo pjesë e qytetit me përfundimin e punimeve të këtij projekti do të jetë zonë turistike pasi që edhe i plotëson kushtet.
Kryetari Latifi ka kërkuar nga punëkryesi që punët t'i kryejë me cilësi të lartë dhe sipas kontratës së nënshkruar. Kurse përgjegjësit e firmës e cila ka marrë projektin për t'i ndërtuar "Shtigjet e ecjes" i ka premtuar kryetarit Latifi se përfundimi i punimeve në këtë projekt do të bëhet para afatit në të cilin është paraparë në kontratë.
Në kuadër të projektit është paraparë të ketë parking në fillimin e shtegut dhe shtëpizë nga druri për informim, këndin për lodra për fëmijë tek vendi i quajtur "Maja e Shkodranit", ndriçim solar, pushimore, ecje publike, drunj dekorativë dhe dy teleskopë. Projekti ka gjatësi prej 1 kilometër e 500 metrash dhe financohet nga Ministria e Zhvillimit Rajonal me 125 mijë euro, kurse Komuna e Rahovecit do të participojë me 10 500 euro.

## Kuçi takohet me bashkatdhetarë, flasin për projektet në Junik



JUNIK, 3 GUSHT (ER) - Në kuadër të ditëve të diasporës, Komuna e Junikut ka mbajtur një takim me bashkatdhetarë dhe dëgjim publik rreth buxhetit për vitin 2019. Në këtë takim, kryetari i Junikut, Agron Kuçi, ka shpalosur disa nga planet të cilat i ka kjo komunë. Në këtë kontekst, ai ka thënë se në të ardhmen parashihet asfaltimi i rrugës Junik-Jasiq-Gjocaj dhe asfaltimi i të gjitha rrugëve sekondare në territorin e Junikut.
Po ashtu, kryetari Kuçi ka thënë se parashihet edhe ndërtimi i një ujësjellësi në lagjen "Agim Ramadani".

# Strategjia serbe për shkëmbimin e territoreve



Dr. Sabri KIÇMARI

Në hulumtim e sipër, për ta dekoduar strategjinë serbe për shkëmbimin e territoreve, një mik imi, shumë i angazhuar në proceset politike dhe shoqërore në Kosovë, më rekomandoi një studim interesant të Fondacionit për Shoqëri të Hapur në Serbi, me titull "Efektet ekonomike, demografike dhe sociale sipas skenarëve të ndryshëm për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës". Autorë të këtij studimi janë Miladin Kovacevic, Dusan Gavrliovic, Dragan Popovic, Milena B. Stevovic, Ljiljana Sekulic dhe Katarina Stancic. Në këtë studim autorët parashtrojnë efektet e mundshme të tri varianteve të rregullimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë: shkëmbimit të territoreve, zgjidhjes sipas Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013 dhe gjendjes së status quo-s. Duke analizuar në detale parashikimet demografike, sociale dhe ekonomike, autorët e studimit arrijnë në përfundimin se varianti i shkëmbimit të territoreve është më profitabël se sa Marrëveshja e Brukselit dhe ruajtja e status quo-s. Ata parashohin që katër komunat e Veriut (Mitrovica e Veriut, Zubin Potoku, Zveçani dhe Leposaviqi) të shkëmbehen me vetëm Preshevën, përderisa Bujanovcin dhe Medvegjen i konsiderojnë pjesë të panegociueshme në një proces shkëmbimi. Këtë e arsyetojnë me faktin se, sipas të dhënave të tyre, në Bujanovc ka vetëm një shumicë të thjeshtë shqiptare (rreth 53,4%), kurse në Medvegj shqiptarët përbëjnë vetëm 7,1%. Në rast realizimi të këtij skenari katër komunat e veriut të Kosovës do të integroheshin në sistemin politik, ekonomik dhe shoqëror të Serbisë, kurse Presheva në atë të Kosovës. Përmes një shkëmbimi të tillë të territorit, Serbia do të shtonte numrin për 12 000 banorë dhe do të rriste territorin e saj për 1 000 km2. Me këtë do të rritej BPV i Serbisë për 90 milionë euro në vit, gjë që në 30 vitet e ardhshme fitimi do të ishte për 2,7 miliardë euro. Si rrjedhim do të rritej klima ekonomike dhe stabilizohej situata politike, gjë që do të sillte deri te rritja e rejtingut kreditor të shtet serb dhe lehtësimin e depërtimit të kapitalit të huaj në Serbi, borxhi i jashtëm do të zvogëlohej nga 24,1 miliardë euro në vitin 2017 në 14,8 miliardë euro në vitin 2030. Në kuadër të këtij varianti studiuesit serb e këshillojnë Qeverinë e Serbisë që të ketë kujdes për të mos lëshuar pe në lidhje me pronësinë mbi Kombinatin "Trepça", "Feronikel"-in dhe termocentralin KEK në Obiliq, edhe pse janë të vetëdijshëm se "është e vështirë që të sigurohen 100 % të pronësisë së shtetit serb mbi to".

Varianti i normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë sipas Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013, sipas autorëve të këtij studimi, do të kishte efekte pozitive për Serbinë, sepse do të mundësohej Bashkësia e Komunave Serbe me një sistem autonomie dhe vetëqeverisjeje brenda territorit të Kosovës, ani që komunat veriore të Kosovës do të mbeteshin de fakto jashtë sistemit ekonomik dhe politik të Serbisë. Ky variant do ti sillte humbje buxhetit të shtetit serb për 47 milionë euro deri në vitin 2030 për të paguar Zyrën Serbe për Kosovën.

Autorët e këtij studimi konstatojnë se varianti i status quo-s është më i dëmshëm se sa dy variantet e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ata shkruajnë se në rast të ruajtjes së status quo-s, pritet që numri i përgjithshëm i popullsisë do të bie në mënyrë drastike për 44% deri në vitin 2060 gjë që do të rezultonte me një balancë të re demografike në rajon. Numri i banorëve të Serbisë pritet të ulet nga 7 095 381, sa ishin në vitin 2015, në 3 957 523 në vitin 2060, koeficienti i të moshuarve do të rritet në mënyrë drastike, kurse fuqia punëtore do të zvogëlohet ndjeshëm. Në territoret e veriut të Kosovës do të rrjedh një proces emigrimi i të rinjve dhe në këtë rajon do të qëndrojnë vetëm njerëz të moshuar, gjë që do të sjell deri te depopullimi drastik i rajonit. Humbjet për Zyrën Serbe për Kosovën në këtë rast do të ishin rreth 1,4 miliardë euro, do të zvogëloheshin ndjeshëm rezervat devizore, investimet direkte dhe do të rritej ndjeshëm papunësia.

Bazuar në këto të dhëna këtij studimi, autorët konstatojnë se Serbisë i konvenon në rrafshin demografik, ekonomik, social dhe strategjik shkëmbimi i territoreve. Të dhëna e parashikimeve të studiuesve serb përputhen në plotëni me deklarimet publike të presidentit serb se "në rast se nuk e zgjidhim tani çështjen e Kosovës do të detyrohemi më vonë të bisedojmë për Vranjën" dhe se "Serbia me marrëveshjen e re do të fitojë më shumë se sa ka shpresuar". Në fakt fjalitë e tilla pasqyrojnë drojën serbe par zhvillimet demografike në Serbi dhe ngutin e tyre për të përfunduar çështjen me shqiptarët gjatë kësaj faze të raporteve në rajon dhe Evropë, të cilat udhëheqja serbe i gjykon si të volitshme.

Por, cilat janë interesat e Kosovës? Cila është strategjia e Kosovës? Cili është varianti më profitabël për Kosovën? Institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, legjislative dhe ekzekutive, duhet të angazhojnë urgjentisht studiuesit në proces: të analizojnë paanshëm rezultatet e marrëveshjeve të deritanishme të Brukselit, të hulumtojnë të dhënat empirike dhe të parashikojnë zhvillimet e ardhshme demografike, ekonomike dhe sociale, të japin mendimin e tyre dhe propozimet konkrete mbi strategjinë dhe realizimin e interesave të vendit. Politika duhet kthyer kokën drejt studiuesve dhe shkencëtarëve, nëse dëshiron të mos futet në qorrsokak.

# Besnik Miftaraj merr çmimin 'Mërgimtari i vitit'

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike në një ceremoni solemne të mbajtur në rezidencën e ish-presidentit Ibrahim Rugova ka dhënë çmimet "Mërgimtari i vitit" në fushat e parapara sipas ligjit në fuqi.



Gjatë kësaj ceremonie, ku nikoqir ishte zëvendëskryeministri, njëherësh ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, morën pjesë edhe ministri i Diasporës i Maqedonisë, Edmond Ademi, nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, familja e presidentit Ibrahim Rugova, si dhe tenori me famë botërore, Ramë Lahaj.

Në këtë ceremoni iu dhanë çmimet pjesëtarëve të diasporës shqiptare për kontributin e tyre dhënë në fushat e ndryshme gjatë vitit, për ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor, historik e gjuhësor shqiptar. Po në këtë ditë u dhanë edhe çmimet për shkrimin/kronikën ose emisionin më të mirë për diasporën.

Çmimi për emisionin më të mirë televiziv iu dha gazetarit nga Danimarka, Ixhet Lutfiu, për dokumentarin "Zëri i shqiptarëve të Danimarkës në vitet 1965-1999".

Çmimi për shkrimin më të mirë në media/portale iu dha gazetares Elvira Berisha për shkrimin "Realiteti politik i ShBA-së në qëndisjet e artistes shqiptare".

Ndërsa në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt, më 1 gusht është mbajtur manifestimi qendror në Prekaz. Manifestimi ka nisur me homazhet te varrezat e Jasharëve, për të vazhduar në Skenderaj, me një koncert festiv për nder të bashkatdhetarëve. Në këtë manifestim, përveç ministrit të Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, kanë qenë të pranishëm presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj, ministri i shtetit për Diasporën i Shqipërisë, Pandeli Majko, kryetari i bashkisë Piana degli Albanesi në Sicili, arbëreshi Rosario Petta, e përfaqësues të tjerë të institucioneve të vendit.

Ministri Gashi dhe homologu i tij, Pandeli Majko, theksuan se nga Prekazi përçohet mesazhi se diaspora është një dhe e pandarë. "Falënderoj bashkatdhetarët për ndihmesën dhënë vendlindjes në momentet më të rënda, duke kontribuar për lirinë që e gëzojmë sot. Shteti i Kosovës do të jetë mirënjohës për angazhimin, rolin dhe punën tuaj", ka thënë presidenti Thaçi në fjalën e tij para të pranishmëve.

Kurse kryeministri Ramush Haradinaj u ka thënë bashkatdhetarëve të vazhdojnë të besojnë në atdheun e tyre. "Së bashku ta forcojmë Kosovën, që të bëhet sikur vendet në të cilat jetoni", u shpreh kryeministri Haradinaj.

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka theksuar se me mburrje e krenari duhet ta pranojnë se pa diasporën shteti ynë nuk do të ishte këtu ku ndodhet sot. "Duke qenë se diaspora shqiptare është një nga shtyllat kryesore të ekonomisë dhe zhvillimit pozitiv të mbarë kombit tonë, ne si institucione kemi obligime të mëdha ndaj bashkatdhetarëve tanë, pa marrë parasysh shtetin ku ata jetojnë", ka thënë Bekim Jashari.



Ndërsa ministri i shtetit për Diasporën i Shqipërisë, Pandeli Majko, ka thënë se sa herë shkojnë në vende të ndryshme të botës, themi se shqiptarët kanë një diasporë. "Shqiptarët kudo që janë, janë një". ka thënë Majko.

## ÇMIMET E DHËNA:

- Çmimi "Mërgimtari i vitit" në fushën e arsimit, shkencës dhe teknologjisë iu dha Besnik Miftarajt
- Çmimi "Mërgimtari i vitit" në fushën e kulturës iu dha tenorit të njohur Ramë Lahaj
- Çmimi "Mërgimtari i vitit" në fushën e sportit iu dha dy futbollistëve shqiptarë, Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit
- Çmimi "Mërgimtari i vitit" në fushën e veprimtarisë afariste iu dha Bekim Brestovcit
- Çmimi i Nderit iu nda Rosario Pettas, kryetar i komunës Hora të Arbëreshëve në Sicili, dhe Agron Bajramit, themelues e koreograf i shkollës së vallëzimit "Shota" në Zvicër
- Çmimi "Mërgimtari i vitit" iu dha Mark Gjonajt, ndërsa çmimi "Postmortem" iu nda ishfutbollistit Fadil Vokrri, njeriu që bëri shumë për njohjen e sportit në arenën ndërkombëtare.

# Kush e urren Adem Demaçin e urren vetveten

*(SHKRUAR NË ORËN 21:00, PASI U MBYLL E PAMJA PËR ADEM DEMAÇIN, MË 31 KORRIK 2018)*

**Prof. dr. Hakif BAJRAMI**



Baca Adem Demaçi ndërroi jetë më 26 korrik 2018 në orën 17:50 minuta. Bacën na e mori Zoti sepse nuk dëshiroi ta mundojë shpirtin e tij, qenien e tij, kritikën e tij, rrethin e tij, sepse nuk deshi prihorizëm mbi të dhe në të, për shkak të injorancës, bajraktarizmit shpifjeve kundër tij dhe arrogancës meskine, plus prepotencës politike të batakxhinjve, të hyjnë në mëkate më tej me një komb të virtytshëm, por me një pari politike mjerisht frikacake nga hija e vet, sepse është mbushur me fajde e pabesi, në çdo gjë. Pra për Demaçin po shkruajnë ata që e kanë njohur e po trillojnë dhe falsifikojnë dokumente, që duhet prokuroria t'i hetojë dhe ta zbardhë me kujdes "dokumentarin kontrabandë të tipizimit Casa nostra". Luajeni, luajeni, por do të falimentoni si Sllobodani i Milloshit.

Baca Adem Dema si e njoh që 28 vjet afër tij, para burgut (1958) ishte në burg pa liri e me plot varfëri; gjatë 28 vjetëve në burg, në tmerr të vetmisë, fyerjes dhe maltretimit fashist; pas burgut ishte i injoruar dhe i fyer nga shumë kënde dhe hapësira vakante psikologjike me porosi të pushtuesit.

Shkurtë, Bacën Zoti e shpëtoi që mos të mundohet e vuaj nga të bëmat e batakxhinjve që mjerisht fitoren madhështore të ushtrisë Adem Jasharit, legjendarit e kanë kthyer në "Pazar me armikun e tërbuar të Karpateve" dhe haxhipishmanët evropian.

Baca shkoi fizikisht. Por çka na la testament? Po, na e ka lënë pasurinë e tërë botës, armen e lirisë dhe kulturën që mos të pushojmë me kritikë objektive, por në të njëjtën kohë mos të sharrojmë në urrejtje. Kështu, mendimi, fjala dhe veprimi kritik, nëse nuk e urrejmë Bacën, atëherë e kemi plotësuar amanetin e tij filozofik dhe humanist që të dyja këto binome të tingëllojnë si Simfonia e Nëntë e Betovenit, si gjenialiteti pikantues i politikës së Leonadro Da Vinçit, si skulptura e Mikelangjellos, si Rubairat e Kahjamit, por me material skalitës që të duket homerik dhe heroik si Gjergj Kastrioti-Skënderbeu.

## Tinëzarët baca nuk i donte

Baca me përjashtim të okupatorit kurrë nuk i ka luftuar ata që e kritikonin publikisht. Por, ka pasur kritika reprogramative nga ata që janë munduar ta pengojnë në shpalosjen e sinqeritetit tij, në masë në shërbim të atdhedashurisë.

Në këtë fushë shumë e ka brengosë Bacën, se nuk kishte fuqi ta luftojë hajnin publike të përligjur me "ligje", sidomos tenderomanin, që ia shiti pasurinë e Kosovës disa kriptomafiozëve, që asgjë nuk kanë bërë për kombin dhe civilizimin. Një ditë, nga viti 2012 duke festuar 100-vjetorin e pavarësisë së shtetit shqiptar do të pyet: "Çka kemi lënë pa kryer për këto vite. Do të pasojë përgjigjja. Bacë, sot ka mjete informative që janë bërë fuqi prodhuese dhe s'ka kthim prapa. Atëbotë kur jepej kushtrimi, sidomos për luftë të drejtë, nga ndonjë kuvend ala i Popovës Llapit 1910, apo Junikut 1912, duhej në majat ma të larta të maleve tona arbërore, të ndezën zjarre. Ajo flakë ishte ftesa që të i përgjigjet kush dëshiron zërin Atëdheut. Tash shumë korba si atëherë janë bërë shqipe por me porositë tua, me mësimin tënd civilizues, si Nëna Terezë nuk do t'ua shtypim kokën, por me sjelljet tona do t'i bindim që të na respektojnë, këta sabotorët tanë dhe urrejtësit e huaj, që si komb i vogël që jemi, si vend që me shumë vështirësi, ata që vendosin në fund, mund ta gjen hartën e Republikës Kosovës (Dardanisë) dhe t'i ndihmojnë, të paktën me mosurrejtje. Po Bacë, shumë anë të Dardanisë sonë janë krasitë me gërshërë nga ata që vendosin pranë tavolinave, ose tinëzisht ose publikisht nëpër metropole. Dhe kanë vendosur se si në Berlin (1878) ishim "emër gjeografik; në Londër (1913) ishim me "kërkesa" të falsifikuara që janë botuar publikisht se një pjesë e Kosovës "kërkon të mbetet me Serbi". Tmerr i paparë, por Evropa u besoi rrenave të Pashiqit; që në Versaj (1919) në vend të një delegacioni shkuan tetë delegacione dhe prapë i njëjti okupator, i njëjti person (N. Pashiqi) falsifikoi që edhe një pjesë e fiseve të Mbishkodrës (të konfesionit katolik me germa latine) "dëshiron" t'i takojë Serbisë e jo Shqipërisë; që një pari e Dibrës (religjioni mysliman me germa arabe) t'i takojë Serbisë e jo Shqipërisë. Për fat gjysmën e pazareve ua prishi Avni Rrustemi. I njëjti skenar do të përsëritet më 1946 në Paris. Aty nuk do të lejohet në fillim Shqipëria e luftës antifashiste të prezantohet denjësisht sepse frikësoheshin se do të hynë në "lojë" edhe çështja e Kosovës. Dhe dolën E. Kardel, M. Piade dhe një diplomat nga Ukraina që ta mbrojnë Shqipërinë. Ndodhi ky atentat me faktin se fjala Kosovë nuk duhej të ndihej, por të krijohet përshtypja se sllavët po e mbrojnë Shqipërinë!

## Adem Dema më 1958 shpërthen si vullkani dhe ua zbulon i pari letrat

Adem Dema i doli në ballë me shpirt kombit në kohën ma të vështirë, sepse armiku ishte mykë në urrejtje për ta shporrë në Anadolli, për të na i mbyllur shkollat dhe për të na lënë sërish sharrëxhinj që t'ua pastrojmë rrugët, t'ua punojmë arat tona me përgjysmë. Po, edhe andej Alpeve shqiptare në Tiranë do të shpërthej komploti antishqiptar dhe ministri Panajot Plaku do të arratiset në Jugosllavi (1957). Baca më 1958 do ta pështpëritë këtë atentat në disa mese por kurrë nuk do të zbulohet. Dhe duke u frikësuar nga fryma e dekolonizmit të botës, më 1959 LKJ do të mbajë plenum ilegal për të adresuar disa padrejtësi ndaj pakicave, duke aluduar në shqiptar, për të marrë kalori të reja për ta sulmuar vetëm Shqipërinë në Lindje dhe në Perëndim. Kështu në kontinuitet, shkëndija që shpërtheu duke i thënë paktit të Varshavës jo më 1960, jam i gatshëm të vdes por do të vdes i izoluar, por do të vdes shqip. Rrugë problematike do të pasojë për tërë kombin shqiptar në Ballkan, sepse armiku tha hapur në Dedinje: "Bëri e na doli çështja shqiptare prej dore, tutje pëllumbi

## TESTAMENTI I ADEM DEMAÇIT

**Agim *Vinca***

*"Babai im, që s'ishte vetëm imi, baca Adem,*
*vdiq i qetë",*
*tha Shqiptar Adem Demaçi më 27 korrik 2018*
*në Prishtinë në Kuvend.*
*E si mund të vdiste ndryshe, pos i qetë,*
*njeriu që ka kryer si askush tjetër*
*detyrën e vet në jetë?*
*"Do të jetë i qetë edhe në atë botë*
*po qe se Atdheu do të frymojë në Paqe e Liri*
*ashtu siç deshi Ai, Baca Adem".*
*Amin, Kosovë, Amen!*

*Strugë, 31 korrik 2018*



# FALEMINDERIT MËRGIMTARË

*Hapi krahët Kosova jonë*
*na erdh vera, na u kthye buzëqeshja*
*nga katër anët e globit jemi nisë*
*me u bashku ku jemi lind e rritë*

*Na ka marrë malli për atë tokë të shenjtë*
*për ato fusha, të bukurat bjeshkë e male*
*djepat kuq e zi, varret e të parëve*
*për familjet, ujin e burimeve, sofrën në shtëpi*
*bukën e nënës, më të mirën meny*

*Na ka marrë malli me i pa shqipet në qiell*
*me u bashku në vallen shqiptare*
*me shiju ndeja, dasma e flija në dreka*
*me na fol shqip nipa e mbesa*

*Mirë se vini o faqebardhë*
*faleminderit mërgimtarë*
*shkuat pa dëshirë, po jetoni me mall*
*dhatë djersë, mund, gjak, lot e pare*
*për atdheun tuaj, tokën e të parëve*

*Na bëtë krenarë në katër anët e botës*
*na dhatë jetë, liri e forcë*
*të mbytur në mall, me zemër të thyer*
*na bëtë të fortë*

*Mirë se vini shqipet tona*
*vendin tuaj s'e zë kush*
*dasmë të madhe bën Kosova*
*të bashkuar s'na tremb kush*

*Oj Kosovë të qofshim falë*
*të kem nënë, na ki vajzë e djalë*
*jem në mërgim të mbushur me mall*
*mundi, djersa, dija jonë*
*janë tuajat përgjithmonë*

*Jetojmë për ty, të kem në zemër*
*E bukura jonë, i shenjti emër.*

**(Arben DRESHAJ)**

i saj i bardhë nuk do të ketë të ndalur sepse në informata do të bëhet i barabartë me neve".

Në këto rrethana do të zihet dhe piqet programi i LRBSH (1963/4) ku thuhet: Nuk ka rendësi a do të na ndihmon Lindja apo Perëndimi, me rendësi është që lufta jonë të jetë e drejtë, për bashkimin e shqiptarëve në një shtet. Në këtë nyje thuren dhe thyejnë qafen të gjitha intrigat ndaj shkollës Demaçiane. Do të jetë luftë e gjatë, por do ta provojmë çdo formë për t'i treguar botës se nuk kërkojmë asnjë milimetër tokë të huaj, nuk kërkojmë t'ia ziejmë jetën askujt. Do të bëjmë politikë pajtuese, por gjakun dhe plagët nuk do t'i falim pa e marrë vesh tërë bota e civilizuar - Baca. Në këtë rrugë të përgjakur të dalësh publikisht dhe të flasësh se me armikun mund të pajtohemi, por gjakun nuk e falim, t'ia shtrish edhe dorën e pajtimit, së pari shqiptarit që me firmën e pushtetit tij i kishte kaluar 28 vjet në kazamte, ka qenë në gjendje ta bëjë vetëm Adem Demaçi, me faktin se ai që ia shtriu dorën publikisht fliste dhe alarmonte diçka të pakuptueshme, sepse e ëmbël ishte fotelja në të gjitha kohërat, por në fund të mbledhë forcë e të thotë tash ai antifashisti që luftoi për Shqipëri doli ndryshe: "Tash jam me Ushtrinë Çlirimtare të Adem Demaçit". Atij duhet jo përulur por duhet falë, se faljen e bënte vetëm shpirti i Adem Demaçit dhe pse mos ta bëjmë ne të tjerët. E filluam epokën e pajtimit kombëtar 1989/90 me fjalët e Adem Demaçit: Jo atij që ngreh gishtin e krimit, por atij që është trim dhe burrë e që e shtrinë dorën e pajtimit!

Ata që nuk e dëgjuan zërin e Adem Demës për ta luftuar urrejtjen, e po ta bënin të kundërtën, ata sot do të ishin shteti ma i respektuar në Evropë. Në këtë luftë permanente Demaçiane kundër urrejtjes paralelisht do të kërkohet që krahas luftës në dy litar: për ta shkatërruar katrahurën Jugosllavi, të ndërtohen shtetet kombe në rrënojat e saj, ku edhe pakicat do ta ndiejnë ngrohtësi sovrane të tyre civilizues, njerëzore si qytetarë të dinjitetshëm dhe të barabartë.

## Pse luftonte Bacë Ademi për këtë kauzë?

Adem Demaçit një diplomat kulminant botëror, Riçard Hollbruk i thotë në pyetjen: "Pse je për shembjen e Jugosllavisë"? Baca do të përgjigjet: Kur sllovenët, kroatët, maqedonët, popujt që jetojnë në Bosnje e flasin serbisht, kroatisht dhe boshnjakisht, e që me gjuhën Vuk Karagjiqit, Ludevid Gajit, Ivan Cankarit, Shantiqit… janë në simbiozë dhe kulturë identike nuk mund të bashkëjetojnë, atëherë çka lypim ne shqiptarët në këtë shtet, sepse së pari nuk jemi sllave, së dyti, nuk jemi të ardhur si këta. Së treti, si është e mundur që malazezët që mbretërinë dhe shtetin e tyre, që e "deponuan" në Serbi më 1918, tani lajmërojnë ndarjen, e kjo është alarm se ne me çdo kusht duhet të largohemi nga robëria serbe. Nëse pajtohen me bisedime, ja ku më keni në qendër të Prishtinës dorën e pajtimit. Nëse nuk pajtoheni, ja ku e keni në qendër të Prishtinës luftën e drejtë që vlen për tërë Kosovën. Por, nëse krimet metastazojnë, nuk besoj se bota e civilizuar do të shikojnë me indiferencë, sepse sot informata është e plasuar në tërë globin, ku ka humanizëm dhe drejtësi por edhe shqiptarë dhe ata nuk do të shikojnë të qetë kah na masakrojnë çetniko-komunistët serbian.

E ne i besojmë humanizmit dhe drejtësisë, u besojmë armeve tona sepse luftën e kemi filluar për t'u darë dhe për ta fituar. Ja shansin e keni, ose të na lejoni që makineria e neofashiste e Ballkanit që quhet Serbi e Milloshit të na shfarosë, ose ta jepni provimin para civilizimit. Cilin çmim jeni të gatshëm ta paguani nuk e di, por dua të them se çmimi i ndonjë pasurie që e përfiton njeriu mund të fiket për dy ditë, me ndonjë katastrofë natyrore, apo me ndonjë kockë njerëzore, por çmimi i ndihmës humane për një populli në robëri, në luftën e tij të drejtë, nuk shterët kurrë, nuk humbë kurrë.

Hollbruku e pranoi solucionin e fitores së përjetshme dhe këtë mision do ta përcjell aty ku duhet dhe ku sigurohet padyshim ardhmëria e drejtë për të gjithë".Besojmë edhe sot. **(Vijon)**

## Bartol: Shpresoj që Maqedonia të hyjë në NATO



SHKUP, 3 GUSHT - Gorazd Bartol, shef i Zyrës së NATO-s në Shkup, shpreson se vitin e ardhshëm, kur Aleanca do ta shënojë 70-vjetorin e themelimit, në selinë e NATO-s në Bruksel do të valojë edhe flamuri i Maqedonisë. Kapiteni detar Bartol sqaron se Maqedonia në Samitin e Brukselit mori ftesë për anëtarësim dhe filloi, siç thotë ai, bisedimet aderuese dhe jo negociatat. "Periudha derisa isha në Shkup ishte shumë interesante dhe me shumë ngjarje. Isha dëshmitar i shumë ngjarjeve që mund ta pengojnë vendin në rrugën drejt integrimeve euroatlantike. Për fat të mirë, punët nisën në drejtim të drejtë. Formimi i Qeverisë vitin e kaluar dhe stabilizimi politik pas zgjedhjeve parlamentare në vitin 2016 ishin hapa shumë pozitivë drejt progresit", tha Bartol. Kapiteni slloven theksoi rëndësinë e zgjidhjes më në fund të mosmarrëveshjes së emrit me Greqinë.

# Eshtrat e ushtarëve amerikanë në luftën koreane

Koreja e Veriut ka kthyer 55 grupe eshtrash që besohet të jenë të trupave amerikane të vrarë në luftën e Koresë. Ato u mirëpritën në një ceremoni zyrtare të mërkurën në Havai, kurse zyrtarët ushtarakë amerikanë njoftuan rreth procesit të identifikimit të eshtrave



Reuters

UASHINGTON, 3 GUSHT - Shtetet e Bashkuara kanë filluar procesin e përpiktë të identifikimit të atyre që besohet të jenë eshtrat e ushtarakëve amerikanë të rënë gjatë luftës së Koresë. Koreja e Veriut ka dorëzuar 55 kuti me eshtra siç u ra dakord gjatë samitit të 12 qershorit mes udhëheqësve amerikanë dhe koreanoveriorë në Singapor. Zyrtarët ushtarakë amerikanë njoftuan të martën mediet rreth procesit të identifikimit të eshtrave. Koreja e Veriut ka kthyer 55 grupe eshtrash që besohet të jenë të trupave amerikane të vrarë në luftën e Koresë. Ato u mirëpritën në një ceremoni zyrtare të mërkurën në Havai.

Pentagoni dha informacione në lidhje me eshtrat dhe hollësi për procesin e përcaktimit të identitetit të tyre. "Eshtrat e këtyre 55 rasteve janë vlerësuar plotësisht në laboratorin tonë dhe tashmë po kalojnë analiza mjeko-ligjore nga dr. John Byrd dhe ekipi i tij shkencor", tha Pentagoni.

Kelly McKeague, kreu i Agjencisë së Mbrojtjes, i ngarkuar me regjistrin e ushtarakëve të humbur, tha se agjencia ka mostrat e ADN-së nga anëtarët e familjes për më shumë se 90 për qind të rreth 7 700 ushtarëve ende të zhdukur nga lufta, por ai tha se ekspertët e mjekësisë ligjore do të përdorin shumë procedura të tjera për t'i identifikuar eshtrat. "Ata përdorin mënyra të shumta të provave. Nëse kemi radiografi të kraharorit që ushtari e ka bërë kur hyri në shërbim, është një tregues për një vështrim analitik. Nëse kemi të dhëna dentare, kjo është një provë edhe më përcaktuese. Pra, duke përdorur këto metoda të shumta për ADN-në, mund ta bëjmë identifikimin për një ushtar të humbur", tha MecKeague.

John Byrd, kreu i ekipit mjekoligjor të agjencisë, thotë se një ekzaminim paraprak sugjeron se eshtrat ka shumë të ngjarë të jenë të ushtarëve amerikanë, por nuk është e qartë të sa prej tyre. "Është pak proces i komplikuar shkencor për të përcaktuar për sa individë bëhet fjalë kur keni eshtra që janë shpesh të fragmentuar dhe në disa raste jo të ruajtur mirë", tha ai.

Rrethanat që shoqërojnë këto eshtra janë në përputhje me gjetjet e mëhershme nga epoka e luftës së Koresë, thotë Byrd. "Provat materiale të gjetura me eshtrat ishin në përputhje me pajisjet ushtarake amerikane të përdorura në luftën e Koresë dhe ishte në një gjendje të përputhet me atë të fushëbetejave të asaj lufte", tha Byrd.

Zyrtarët e mbrojtjes thonë se procesi i identifikimit mund të zgjasë një vit ose më shumë para se ekspertët të mund të arrijnë në konkluzione përfundimtare. Sapo të identifikohet, eshtrat do të transferohen te të afërmit për varrim.

Lufta Koreane nisi në qershor të vitit 1950, pas një serie përleshjesh kufitare mes Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut. Ajo përfundoi me një armëpushim të nënshkruar në korrik të vitit 1953. Më shumë se 33 000 trupa amerikane u vranë në luftë.

# Edhe Turqia kërcënon Amerikën



ANKARA, 3 GUSHT - Ministri i Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu, deklaroi se sanksionet e ShBA-së nuk do të mbeten pa përgjigje. Ai e dënoi "qëndrimin agresiv" të ShBA-së dhe kërkoi tërheqjen e "vendimit të gabuar". Ndërkohë, sekretari i ShBA-së për marrëdhëniet me jashtë, Mike Pompeo, sipas të dhënave të tij, do të takohet javën e ardhshme me ministrin e Jashtëm turk Cavusoglu.

Të mërkurën ShBA-ja vendosi sanksione kundër ministrit turk të Drejtësisë, Abdulhamit Gül dhe ministrit të Brendshëm, Süleyman Soylu, sepse i shohin ata si përgjegjës për ndalimin dhe arrestimin e priftit amerikan Andrew Brunson.

Vitin e kaluar presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan pati propozuar që Brunsoni të shkëmbehet me predikuesin që jeton në ShBA në mërgim, Fetullah Gylen. Lëvizjen e tij Turqia e bën përgjegjëse për tentativën për puç në qershor 2016. Gylen e ka hedhur poshtë këtë. Qeveria e ShBA-së e refuzon shkëmbimin. Ministri i Brendshëm Soylu bëri të ditur se Gylenin do ta "marrin" nga ShBA-ja. Brunsonin e arrestuan në tetor 2016 për spiunazh si dhe mbështetje të Partisë së ndaluar Punëtore Kurde PKK dhe të lëvizjes Gylen. Pas bërjes së ditur të sanksioneve të ShBA-së, monedha turke, Lira, humbi 1,6 për qind të vlerës së saj. Po të ashpërsohet kriza, presioni ndaj monedhës turke mund të shtohet. Ajo ka muaj që po e humbet vlerën.

## Kulla Eiffel mbyllet për vizitorët



PARIS, 3 GUSHT - Është mbyllur kulla e Parisit për turistë ngaqë punëtorët kanë pasur një mosmarrëveshje me menaxherët. Gjithë ky problem është bërë rreth një vendimi për të caktuar ashensorë të veçantë për vizitorët me bileta të rezervuara dhe ata që i blejnë në vend.

Aktualisht kulla mund të pranojë vetëm gjysmën e vizitorëve që kanë rezervuar biletat e tyre nëpërmjet internetit. Punonjësit thonë se ndryshimet kanë rezultuar në radhët e gjata që mund të zgjasin deri në tri orë për ata që presin të paguajnë për bileta në vend, si dhe deri në një orë për ata që kanë rezervuar biletat në mënyrë elektronike.

Kulla Eiffel është një nga atraksionet më të njohura në botë dhe turistët që kanë ardhur ta shohin qytetin nga maja ishin zhgënjyer.

E rrallë

## Drerët pushtojnë tunelet për t'u mbrojtur nga i nxehti



Për shkak të nxehtit të lartë në Arktik, autoritetet norvegjeze u kanë bërë thirrje automobilistëve ta rrisin vëmendjen përballë drerëve që kanë filluar të strehohen nëpër tunele për t'u mbrojtur nga temperaturat e larta.

FOTO E DITES




Në provincën lindore të Kinës në Shandong punëtorët korrnin lule zambaku. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Telefoni celular shpërthen në flakë në avion




Një fluturim i Ryanair për në Ibizia u anulua pasi një celular lëshoi flakë brenda kabinës, duke shkaktuar frikë tek pasagjerët në bord. Udhëtarët u detyruan të largohen përpara se të niseshin nga aeroporti i Barcelonës El Prat. Një pasagjer kishte lidhur telefonin me një bateri paketë, kur ajo shpërtheu në zjarr, duke bërë që telefoni të binte në dysheme.

## BARSOLETA E DITËS



**Gjakovari**
**- Sa vaj ulliri ke shpenzuar gjatë javës?, pyet gjakovari shokun e vet nga Ferizaj.**
**- Gjysmë shishe.**
**- Po ti?, e pyet shoku gjakovarin.**
**- Unë shpenzoj vetëm duke e shikuar shishen.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC




Vetem gjate vikendit
në ora 16:00

### "INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird




Në ora 18:20

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco

Në ora 20:00

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed







Në ora 22:00

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Një ditë e mbushur me kënaqësi të vogla që do t'ju bëjnë më tolerant dhe më të dashur me familjen tuaj. Kishit kohë pa u ndier kështu.



**DEMI**
Keni lejuar që problemet e punës të bëhen pjesë e jetës suaj personale dhe kjo do t'ju krijojë mjaft ngërç në komunikimin me partnerin.



**BINJAKËT**
Dikush ju ka përfshirë pa dëshirën tuaj në një marrëdhënie mjaft të komplikuar. Të pamundur për të dalë, do të bëheni pjesë e rrjedhës.



**GAFORRJA**
Sot ndiheni shumë mirë me veten sepse keni zbuluar çelësin se si të jeni të lumtur edhe nga gjërat e vogla që mbushin ditën tuaj.



**LUANI**
Situatat që po ju ndodhin kohët e fundit janë shumë të ndikueshme nga gjendja juaj emocionale. Mundohuni ta ndani arsyen nga ndjenja.



**VIRGJËRESHA**
Përvoja juaj ju ka mësuar të mos flisni para kohe për çështje që nuk i njihni mirë. Heshtja tregon më shumë se fjalët.



**PESHORJA**
Në sipërfaqe duket sikur jeni shumë në rregull, por në brendësi ka një çështje që po ju shqetëson dhe një person që tërheq gjithë vëmendjen tuaj.



**AKREPI**
Ju mungon përqendrimi, por duhet patjetër të sforcoheni sepse një projekt i caktuar që keni marrë përsipër kërkon gjithë vëmendjen tuaj.



**SHIGJETARI**
Megjithëse e keni të qartë se cila do të jetë e ardhmja juaj, përsëri doni të jeni të sigurt nga ana financiare për ta përballuar.



**BRICJAPI**
Gjithçka që mund të bëni sot është të kënaqeni veten tuaj duke i bërë sa më të këndshme çastet e ndryshme që do t'jua ofrojë dita.



**UJORI**
Respektin që kanë të tjerët karshi jush e keni vendosur më shumë mund. Një keqkuptim i vogël mund të prish të gjithë imazhin e krijuar.



**PESHQIT**
Mos u trembni nëse duhet t'i ndryshoni në moment të fundit projektet tuaja. Ndonjëherë ndryshimet janë shumë të mira.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | BRENTFORD - ROTHERHAM | 3+ | WIGAN - SHEFF WED | 1 | SHREWSBURY - BRADFORD | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Vit i suksesshëm për Dritën



KF Drita në edicionin 2017/2018 e fitoi titullin e kampiones, më pas debutoi në garat ndërkombëtare. Kapiteni Ardian Limani e ka vlerësuar vit të suksesshëm për skuadrën e tij, kurse ka paralajmëruar se Dita sërish do të synojë trofetë në futbollin e Kosovës. "Besojmë fuqishëm te mos u kemi zhgënjyer gjatë gjithë këtij viti, sepse Drita veçse ka shkruar historinë. Presim nga ju përsëri të jeni arma jonë kryesore për arritjen e trofeve", ka thënë Limani

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 3 gusht** - KF Drita nga Gjilani të enjten në mbrëmje është eliminuar nga Liga e Evropës pasi ka luajtur baras në ndeshjen kthyese ndaj Dudelanges (1-1), derisa ndeshja e parë në Luksemburg kishte përfunduar 2-1. Klubi nga Gjilani paraprakisht ishte eliminuar edhe nga Liga e Kampionëve pasi humbi dy ndeshjet ndaj skuadrës së fortë suedeze, Malmo, me rezultat të përgjithshëm 5-0. Mirëpo paraprakisht, Drita eliminoi dy skuadrat Santa Coloman (2-0) dhe Lincoln Reds Imps (4-1). Kapiteni i kësaj skuadre, Ardian Limani, i cili ishte golashënues në ndeshjen ndaj Dudelanges, ka vlerësuar se ky vit ka qenë i suksesshëm për skuadrën e Dritës. "Faleminderit tifozëve dhe qytetarëve për përkrahjen e vazhdueshme në garat evropiane! Besojmë fuqishëm të mos ju kemi zhgënjyer gjatë gjithë këtij viti, sepse Drita veçse ka shkruar historinë. Ne presim nga ju përsëri të jeni arma jonë kryesore për arritjen e objektivave, që natyrisht se janë trofetë", ka thënë Limani.

Drita për të marrë pjesë në garat ndërkombëtare bëri një edicion të mirë në elitën e futbollit të Kosovës, duke u shpallur kampion pas plot 15 vjetësh. Rezultatet e kësaj skuadre i vlerësoj historike kryetari i klubit, Valon Murseli. "Faleminderit djema për emocionet që na dhuruat! Faleminderit që besimin që e kisha në ju ma kthyet me suksese historike, suksese që vetëm ju mund t'i arrini dhe t'i tejkaloni sezonin që vjen. Kokën lart dhe vazhdojmë së bashku rrugën drejt sukseseve të tjera. Krenar me ju, krenar me 'Intelektualët'", ka thënë Murseli. Pas eliminimit nga garat ndërkombëtare, trajneri Bekim Isufi ka vlerësuar se skuadra e Dritës e ka arritur maksimumin. "Në pjesën e parë luajtëm shumë mirë, kurse në pjesën e dytë u ndëshkuam dhe ai gol na i prishi planet. Krijuam disa raste, por nuk ishim konkret. Jam i kënaqur me paraqiten e lojtarëve në gjashtë ndeshjet e garave evropiane. Ne e kemi arritur maksimumin", ka deklaruar Isufi. Drita mbrojtjen e titullit e nis me ndeshjen kundër KEK-ut, e cila zhvillohet në stadiumin e qytetit në Gjilan.

### Në edicionin tjetër tri klube të Kosovës në garat evropiane

Paraqitjet e mira të kampiones së Kosovës, Dritës dhe fitues së Kupës, Prishtinës, në garat evropiane, kanë bërë që prej edicionit të ardhshëm në garat e UEFA-s të shkojnë tri ekipe nga Kosova. Skuadra kampione e Kosovës për edicionin e ri do të luajë në Ligën e Kampionëve, kurse nënkampionia dhe fituesja e Kupës do të marrin pjesë në Ligën e Evropës. Drita i ka mposhtur dy kundërshtarë në turneun parakualifikues të Ligës së Kampionëve, ndërsa është eliminuar në xhiron e parë kualifikuese. Pastaj gjilanasit vazhduan në xhiron e dytë eliminatore të Ligës së Evropës, por aty u eliminuan. Në dy edicionet e mëparshme Kosova ka marrë pjesë me nga dy klube në garat evropiane. Ndërsa Prishtina në kualifikimet e Ligës së Evropës sivjet e kaloi xhiron e parë, kurse u eliminua në të dytën nga Fola Esch.

## SHKURT

### Bekim Isufi nuk largohet nga Drita

